



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

RREGULLORE

Nr. 10, datë 11.06.2019

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT TË REGJISTRIMIT
DHE
PËRDITËSIMIN E REGJISTRIT PUBLIK**

Ndryshuar me Vendim Nr. 31, datë 28.05.2020 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

Kjo rregullore është hartuar në bazë të:

nenit 3, nenit 5, pika a, b, c, f dhe h, nenit 11 pika 3, nenit 19, nenit 20, nenit 21, nenit 22, nenit 23, nenit 24, nenit 25, nenit 26, nenit 27, nenit 28 dhe nenit 29, nenit 30, nenit 31, si dhe nenit 60, pika 2 e ligjit nr.10091/2009, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar me ligjin 47/2016, ligjit 9917 datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit” i ndryshuar, neni 24 pika 2, VKM nr.343 datë 08.04.2009 “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të autoriteteve licencuese dhe/ose mbikëqyrëse”, i ndryshuar, neni 7 i ligjit nr.157/2013 “Për masat e marra kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar¹, Statutin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike, Rregulloren nr. 2, datë 22.02.2018 “Për funksionimin e Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale dhe mbikëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për auditues ligjor dhe kontabilist të miratuar”. Bordi i Mbikëqyrjes Publike miraton këtë Rregullore:

¹ *Ndryshuar me Vendim Nr. 31, datë 28.05.2020 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike*

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i Rregullores dhe fusha e veprimit

Objekti i Rregullores është:

1. Organizimi dhe funksionimi i Komitetit të Regjistrimit;
2. Procedurat e regjistrimit dhe të çregjistrimit nga regjistri publik i audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese vendase dhe të huaja;
3. Procedurat e organizatës profesionale të audituesve ligjorë për pasqyrimin e ndryshimeve në Regjistrin Publik.
4. Mbikëqyrja nëpërmjet inspektimeve tematike të zbatimit të kërkesave të kësaj rregulloreje².

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMITETIT TË REGJISTRIMIT

Neni 2

Krijimi dhe përbërja

1. “Komiteti i regjistrimit” është organi i ngritur pranë organizatës profesionale të audituesve ligjorë, që merret me procedurat e regjistrimit dhe çregjistrimit në regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit. Ai krijohet në përputhje me dispozitat e nenit 19, pika 1 të ligjit 10091/2009, i ndryshuar.
2. Komiteti i Regjistrimit përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët emërohen për një periudhë katërvjeçare nga Këshilli Drejtues i organizatës profesionale, sipas propozimeve të mëposhtme:
 - a) tre anëtarë, me propozim nga Këshilli Drejtues i organizatës profesionale të audituesve ligjorë,
 - b) dy anëtarë, respektivisht nga ministria përgjegjëse për financat dhe ekonominë, me profil në fushën e ekonomisë dhe/ose jurisprudencës, si dhe me njohuri në fushën e kontabilitetit, auditimit dhe financës.
3. Kryetari i Komitetit të Regjistrimit përzgjidhet një nga anëtarët e propozuar të organizatës profesionale të audituesve ligjorë.

² Shtuar me Vendim Nr. 31, datë 28.05.2020 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

4. Me propozim të Kryetarit, njëri nga anëtarët e propozuar sipas pikës 2 (b) të këtij neni përzgjidhet nënkryetar me votën e shumicës së anëtarëve të Komitetit të Regjistrimit.
5. Anëtarët e Komitetit të Regjistrimit duhet të jenë individë të diplomuar dhe të specializuar me profil në fushën e ekonomisë dhe/ose jurisprudencës, si dhe me njohuri në fushën e kontabilitetit, auditimit dhe financës dhe të mos jenë në kushtet e konfliktit të interesit në ushtrimin e kompetencave të tyre, si dhe nuk duhet të mbajnë funksione ekzekutive pranë organizatës profesionale të audituesve ligjorë. Në rastet e konfliktit të përshkohshëm të interesit që lidhet me ushtrimin e kompetencave, anëtari duhet të sigurohet që të marrë masat për shmangien e konfliktit.

Neni 3 **Procedurat e punës**

1. Komiteti i Regjistrimit mbledhet me thirrjen e Kryetarit të tij, një herë në dy muaj, javën e parë të muajit të dytë pasardhës. Vendimmarrja bëhet në datat e përcaktuara në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore. Në mungesë të kryetarit, mbledhjet drejtohen nga nënkryetari.
2. Anëtarët e Komitetit njoftohen nga sekretaria teknike e organizatës profesionale të audituesve ligjorë me kërkesë të kryetarit, ose sipas dispozitave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, të paktën 5 ditë para datës së mbledhjes. Njoftimi përmban datën, orën, rendin e ditës, si dhe relacionin përkatës.
3. Komiteti Regjistrimit është përgjegjës për të shqyrtuar materialet dhe përgatitur relacionin për kërkesat e paraqitura nga aplikuesit. Ai asistohet nga sekretaria teknike e organizatës profesionale të audituesve ligjorë.
4. Kryetari i Komitetit të Regjistrimit mban kontakte dhe komunikim të vazhdueshëm me organizatën profesionale të audituesve ligjorë, duke u informuar për çdo kërkesë të paraqitur pranë saj.
5. Mbledhjet e Komitetit të Regjistrimit janë të vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se 3 anëtarë. Vendimet merren me shumicën e votave (jo më pak se tre vota) dhe nënshkruhen nga të gjithë anëtarët. Vendimet kundër duhet të jenë të argumentuara në procesverbal. Vendimet depozitohen në selinë e organizatës profesionale të audituesve ligjorë. Çdo vendim i Komitetit të Regjistrimit i njoftohet aplikuesit brenda 10 ditëve, nëpërmjet sekretarisë së organizatës profesionale të audituesve ligjorë. Vendimet e lidhura pasqyrohen në regjistrin publik të audituesve ligjorë.

6. Mbledhjet e Komitetit të Regjistrimit dokumentohen me procesverbal, i cili nënshkruhet nga Kryetari dhe nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës.
7. Vendimet për rrëzimin e kërkesave për t'u regjistruar në regjistrin publik të organizatës profesionale të audituesve ligjorë duhet të jenë të arsyetuara.
8. Gjatë shqyrtimit të rasteve të paraqitura për regjistrim/çregjistrim, Komiteti i Regjistrimit udhëhiqet nga parimi i pjesëmarrjes së aplikuesit të përfshirë në çështjen që trajtohet, nëpërmjet vënies në dijeni, dëgjimit dhe verifikimit të rastit dhe të trajtimit të tij në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë.
9. Kur e gjykon të nevojshme, Komiteti i Regjistrimit organizon seanca dëgjimore të aplikuesit, që ka paraqitur kërkesën për regjistrim/çregjistrim.
10. Secili prej anëtarëve të Komitetit të Regjistrimit, kur gjykon se procedurat e ndjekura lidhur me funksionet dhe vendimmarrjen e komitetit nuk janë zbatuar në pajtueshmëri me këtë rregullore apo me legjislacionin në fuqi, vë në dijeni BMP lidhur me parregullsitë e procesit.
11. Vendimet e Komitetit të Regjistrimit mund të apelojnë pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike. Apelimet bëhen brenda 45 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit.

Neni 4

Lirimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Komitetit të Regjistrimit

1. Anëtari i Komitetit të Regjistrimit lirohet nga detyra në rastet kur:
 - a) mbaron mandati;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) çregjistrohet nga regjistri publik, ose ka pezulluar përkohësisht ushtrimin e veprimtarisë si auditues ligjor;
 - d) përfundon marrëdhënia e punës me institucionin që ai përfaqëson, në rastet kur anëtari vjen nga institucionet publike.
2. Këshilli Drejtues i organizatës profesionale të audituesve ligjorë ka të drejtë të shkarkojë një anëtar të Komitetit të Regjistrimit, kur:
 - a) Nuk merr pjesë, pa arsye, në mbledhjet e Komitetit të Regjistrimit për më shumë se katër herë radhazi;
 - b) Veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtonuar rëndë veprimtarinë dhe emrin e organizatës profesionale të audituesve ligjorë, Komitetit të Regjistrimit dhe Bordit të Mbikëqyrje Publike;
 - c) Nuk përmbush funksionet e parashikuara nga ligji dhe kjo rregullore;

- ç) Dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;
 - d) Për shkaqe sëmundjesh fizike ose mendore, gjë që i bën të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara;
 - dh) Për shkelje të kuadrit rregullator në fuqi.
3. Këshilli Drejtues, në rastet kur anëtari i Komitetit të Regjistrimit lirohet, shkarkohet, dorëhiqet apo vdes, duhet të caktojë zëvendësuesin e tij brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh pune, duke filluar nga data e njoftimit të lirimit, shkarkimit, dorëheqjes apo vdekjes, në përputhje me procedurat e përzgjedhjes.
 4. Mandati i zëvendësuesit llogaritet për pjesën e mbetur nga dita e emërimit të tij.

KREU III

PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË AUDITUESVE LIGJORË DHE TË SHOQËRIVE AUDITUESE

Neni 5

Regjistrimi në përfundim të provimit të aftësisë profesionale

1. Pas përfundimit të provimeve të aftësisë profesionale, kandidatët për auditues ligjorë aplikojnë për regjistrim dhe dorëzojnë pranë organizatës profesionale dokumentacionin e lëshuar në pajtueshmëri me kuadrin rregullator të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, që tregojnë përfundimin me sukses të provimit të aftësive profesionale.
2. Mbi bazën e këtyre dokumenteve, Komiteti i Regjistrimit pajis audituesit ligjorë me një numër individual unik. Organizata profesionale e audituesve ligjorë lëshon licencën profesionale, në të cilën shënohet numri unik i audituesit ligjor. Ushtrimi i profesionit në praktikë kryhet vetëm pas përfshirjes në regjistrin publik.

Neni 6

Regjistrimi i audituesve ligjorë në regjistrin publik të audituesve ligjorë

1. Regjistrimi është procesi i përfshirjes së audituesve ligjorë vendas dhe të huaj, si dhe i shoqërive të auditimit vendase dhe të huaja në regjistrin publik të audituesve ligjorë.
2. Të drejtën për t'u regjistruar në regjistrin publik e kanë të gjithë personat fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, që plotësojnë kushtet e përcaktuara në ligjin nr. 10091/2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.
3. Kërkesa e aplikuesit për regjistrim i adresohet, me shkrim, Komitetit të Regjistrimit, përmes organizatës profesionale të audituesve ligjorë. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentet e nevojshme, që tregojnë për përfundimin me sukses të provimeve të aftësisë profesionale, si dhe të deklaratës së lëshuar

në përgjegjësinë personale të individit, për dhënien fund të papajtueshmërive, që kërkohen për ushtrimin e profesionit në praktikë dhe për garancitë etike e morale.

4. Audituesit ligjorë në bazë të vendimit të Komitetit të Regjistrimit përfshihen në regjistrin publik, i cili mbahet dhe përditësohet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë. Vetëm pas kësaj përfshirjeje, ata kanë të drejtë të kryejnë veprimtarinë e auditimit ligjor të pasqyrave financiare, individuale dhe/ose të konsoliduara të shoqërive tregtare, si edhe të kryejnë shërbime të tjera apo shërbime të lidhura, kur ato nuk bien ndesh me kërkesat e parashikuara në këtë ligj, me standardet profesionale dhe me kodin e etikës.

Neni 7

Regjistrimi i shoqërive audituese

Komiteti i Regjistrimit e regjistron një shoqëri audituese për kryerjen e auditimit ligjor të pasqyrave financiare, individuale dhe/ose të konsoliduara të shoqërive tregtare, që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, në qoftë se shoqëria audituese plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) është themeluar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe është regjistruar sipas kërkesave të ligjit nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit, kur është e huaj;
- b) shumica e të drejtave të votës në kapitalin e shoqërisë zotërohen nga shoqëri audituese, vendase ose të huaja, ose nga auditues ligjorë;
- c) shumica deri në maksimumin 75 për qind e anëtarëve të organit drejtues ose administrativ të shoqërisë audituese janë auditues ligjorë, vendas ose të huaj, të njohur nga Komiteti i Regjistrimit dhe të regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë. Kur organi drejtues ose administrativ nuk ka më shumë se dy anëtarë, të paktën njëri prej këtyre anëtarëve duhet të plotësojë kushtet e përmendura në këtë shkronjë;
- ç) shoqëria angazhon auditues ligjorë, vendas ose të huaj, të cilët janë të regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë;
- d) shoqëria gëzon reputacion të mirë (personat e angazhuar me drejtimin e shoqërisë apo të punësuarit plotësojnë kushtet sipas dokumentacionit të parashikuar në nenin 8 në lidhje me vërtetimin për gjendjen gjyqësore, dëshminë e penaltetit dhe ndaj tyre nuk ka pasur masa të mëparshme disiplinore).

Neni 8

Dokumentet që kërkohen për regjistrimin e audituesve ligjorë

1. Për t’u regjistruar në regjistrin publik audituesi ligjor i drejtohet me shkrim Komitetit të Regjistrimit pranë organizatës profesionale të audituesve ligjorë. Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim përmban sa më poshtë:
 - a) Për audituesit ligjorë shtetas shqiptarë:
 - Kërkesa e aplikuesit drejtuar Komitetit të Regjistrimit, e nënshkruar prej

tij;

- Curriculum vitae;
- Dokument identiteti;
- Vërtetim nga prokuroria e rrethit se ndaj shtetasit nuk është filluar çështje penale; vërtetim nga gjykata e rrethit se kërkuesi nuk është në proces gjyqësor;³
- Certifikatë e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti), që tregon se aplikuesi nuk është i dënuar;
- Deklaratë noteriale për dhënien fund të papajtueshmërive që kërkohen për ushtrimin e profesionit;
- Kopje e njehsuar e certifikatës së titullit auditues ligjor ose vërtetimin për përfundimin me sukses të provimeve të aftësive profesionale.
- Vërtetim nga organizata profesionale e audituesve ligjorë ose nga institucionet dhe subjektet e tjera të parashikuara me ligj për pjesëmarrjen në kualifikimin e vijueshëm profesional për kohën që nuk ka ushtruar profesionin e audituesit ligjor (nëse është e përshtatshme);
- Vërtetim nga organizata profesionale e audituesve ligjorë për shlyerjen e detyrimeve financiare lidhur me kuotat e anëtarësisë dhe detyrime të tjera (nëse është e përshtatshme);
- Certifikatën e regjistrimit në QKB dhe/ose kopje të Ekstraktit të QKB;
- Në rastet kur në momentin e aplikimit nuk zotërohet dëshmia e penalitetit dhe vërtetimi i gjendjes gjyqësore aplikuesi dorëzon një vetë deklaram mbi gjendjen gjyqësore deri në dorëzimin e dokumenteve të përcaktuara në këtë nen.

b) Për audituesit ligjorë shtetas të huaj

- Për t'u regjistruar në regjistrin publik, audituesi ligjor i huaj fillimisht i drejtohet me një kërkesë me shkrim për dhënien e provimit të aftësive profesionale Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale, duke paraqitur dokumentacionin e nevojshëm, që tregon për titullin e marrë në një shtet tjetër.
- Përmbajtja e dokumentacionit, që paraqitet për regjistrimin e audituesit ligjor të huaj dhe të shoqërive të huaja audituese në regjistrin publik të audituesve ligjorë përcaktohet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike dhe miratohet nga Ministri i Financave.
- Këshilli Drejtues i organizatës profesionale bën vlerësimin e pajtueshmërisë së kushteve të përgatitjes së audituesve ligjorë të huaj me kushtet e përgatitjes së audituesve ligjorë vendas dhe i dërgon një raport Komitetit të Regjistrimit.
- Dëshmi të penalitetit të nxjerrë brenda 6-mujorit të fundit nga shteti ku ka rezidencën e përhershme të apostiluar.⁴

2. Mbajtësit e titullit auditues ligjor të një shteti tjetër përveç sa më sipër, duhet të

³ Ndryshuar me Vendim Nr. 31, datë 28.05.2020 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

⁴ Shtuar me Vendim Nr. 31, datë 28.05.2020 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

dorëzojnë edhe vendimin e Këshillit Drejtues të organizatës profesionale për njohjen/vlerësimin e titullit në të cilin janë përcaktuar dhe provimet që duhet të japë aplikuesi në përputhje me referencat ligjore.

Neni 9

Regjistrim i shoqërive audituese në Regjistrin Publik të audituesve ligjorë

1. Për t'u regjistruar, një shoqëri audituese, në regjistrin publik që vepron në Republikën e Shqipërisë nëse shoqëria audituese plotëson kushtet e parashikuara më poshtë:
 - a. është themeluar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe është regjistruar sipas kërkesave të ligjit nr. 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit, kur është e huaj
 - b. shumica e të drejtave të votës në kapitalin e shoqërisë zotërohen nga shoqëri audituese, vendase ose të huaja, ose nga auditues ligjorë;
 - c. shumica deri në maksimumin 75 për qind e anëtarëve të organit drejtues ose administrativ të shoqërisë audituese janë auditues ligjorë, vendas ose të huaj, të njohur nga Komiteti i Regjistrimit dhe të regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë. Kur organi drejtues ose administrativ nuk ka më shumë se dy anëtarë, të paktën njëri prej këtyre anëtarëve duhet të plotësojë kushtet e përmendura në këtë shkronjë;
 - ç. shoqëria angazhon auditues ligjorë, vendas ose të huaj, të cilët janë të regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë;
 - d. shoqëria gëzon reputacion të mirë.
2. Kërkesa për regjistrim të shoqërisë në regjistrin publik, bëhet nga administratori i shoqërisë i cili duhet të jetë i regjistruar si auditues ligjorë dhe shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Për shoqëritë audituese:
 - Vendimi i asamblesë së ortakëve/aksionerëve për regjistrimin e shoqërisë në regjistrin publik të audituesve ligjorë;
 - Certifikatën e regjistrimit në QKB (NUIS);
 - Statuti i shoqërisë;
 - Listën e audituesve të shoqërisë, përfshirë dhe administratorin, të cilët plotësojnë kushtet për të ushtruar profesionin e audituesit ligjorë dhe nuk janë ushtrues të profesionit si person fizik;
 - Në rastin e individëve ortakë të shoqërisë së auditimit, të cilët nuk janë auditues ligjor, duhet të paraqitet dokumentacioni dhe të dokumentohet në dosjen e regjistrimit të shoqërisë së auditimit:
 - Dokument identifikimi biometrik i vlefshëm;
 - Vërtetim nga prokuroria e rrethit se ndaj shtetasit nuk është filluar çështje penale; vërtetim nga gjykata e rrethit se kërkuesi nuk është në proces gjyqësor;
 - Certifikatë e gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti), që tregon se

- aplikuesi nuk është i dënuar;
- Verifikimi (nga Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë) në listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit;⁵
 - Në rastin kur në pronësinë e shoqërisë së auditimit zotëruesi i kuotave është një person juridik (shoqëri jo-auditimi), në dosjen e shoqërisë së auditimit do të dokumentohen të dhënat për të gjithë pronarët (individë) e fundit përfitues të personit juridik sipas të njëjtave kërkesa, për dokumentacion të individëve ortakë që nuk janë auditues ligjorë dhe të gjithë personave që janë pjesë e organeve të drejtimit apo kanë autoritet vendimarrës⁶.
3. Të dhëna të tjera, sipas nenit 29 të ligjit nr.10091/2009,“Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.
 4. Dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe në përputhje me kërkesat ligjore të Republikës së Shqipërisë (origjinal ose i noterizuar).

Neni 10

Pezullimi i veprimtarisë së audituesit ligjor

1. Audituesi ligjor, me një kërkesë për pezullimin e ushtrimit të veprimtarisë, mund të kërkojë të tërhiqet përkohësisht nga ushtrimi i profesionit.
2. Kërkesa për pezullim i drejtohet me shkrim Komitetit të Regjistrimit, përmes organizatës profesionale të audituesve ligjorë. Ajo duhet të jetë e motivuar dhe të tregojë veprimtarinë e re, që do të ndërmarrë i interesuari, si dhe periudhën për të cilën kërkohet pezullimi apo, kur kjo periudhë nuk mund të identifikohet, datën në të cilën kërkohet të fillojë pezullimi.
3. Komiteti i Regjistrimit e shqyrton kërkesën në mbledhjen e tij më të parë dhe nëse çmon se veprimtaria e tij e re nuk është e natyrës që u sjell dëm interesave etikë e moralë të profesionit, e miraton kërkesën dhe vendos fshirjen e përkohshme të të interesuarit nga regjistri publik i audituesve ligjorë.
Dokumentet dhe faktet e deklaruara gjatë procedurave të pezullimit të përkohshëm të ushtrimit të profesionit verifikohen nga Komiteti i Regjistrimit dhe në rastin kur konstatohen parregullsi të mundshme zbatohen dispozitat e rregullores nr. 4, datë 29.03.2018 “Për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore”. Kopje e vendimit i dërgohet organizatës profesionale për të reflektuar informacionin e duhur në regjistrin publik të audituesve ligjorë.
4. Audituesi ligjor i cili për një periudhë të caktuar kohe ka pezulluar veprimtarinë si auditues ligjor, ka të drejtë të ri-nisë atë përpara marrjes së vendimit nga Komiteti i Regjistrimit, me kusht që të informojë për këtë, me shkrim, organizatën profesionale të audituesve ligjorë, të paktën dhjetë ditë më parë, si dhe të ketë shlyer kuotat profesionale. Në rastet kur audituesi ligjor ka ri-nisur veprimtarinë përpara marrjes së vendimit nga Komiteti i Regjistrimit dhe ky i

⁵ Shtuar me Vendim Nr. 31, datë 28.05.2020 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

⁶ Shtuar me Vendim Nr. 31, datë 28.05.2020 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

fundit vëren, gjatë shqyrtimit, se veprimtaria e tij e re është e natyrës, që u sjell dëm interesave etikë e moralë të profesionit, vendos çregjistrimin e audituesit ligjor nga regjistri publik i audituesve ligjorë.

Përcaktimi i veprimeve që u sjell dëm interesave etikë e moralë të profesionit bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në rregulloren nr. 4, datë 29.03.2018 të miratuar nga BMP, dhe miratohet nga BMP. Në rast se nuk vërehen këto veprime Komiteti Regjistrimit procedon normalisht kërkesën në përputhje me këtë rregullore.

5. Nga data e njoftimit të vendimit, që shpall fshirjen e përkohshme nga regjistri publik, i interesuari nuk është më anëtar i organizatës profesionale. Ai nuk mund të ushtrojë në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e vet profesionin e audituesit ligjor dhe as ta përdorë këtë titull për shërbime të përcaktuara në ligj, angazhimi i të cilave është atribut i ushtruesit të profesionit të cilët janë pjesë e regjistrimit publik.
6. Fshirja e përkohshme nga regjistri publik, me kërkesën e audituesit ligjor, nuk ka efekt mbi procedurat disiplinore, të nisura për shkeljet e kryera prej tij përpara fshirjes.
7. Efektet e pezullimit të ushtrimit të veprimtarisë fillojnë në datën më të hershme midis datës së kërkesës së audituesit ligjor për pezullim ose datës së ndryshimit të kushteve të domosdoshme të lidhura me pjesëmarrjen në kapital (p.sh. kontrata e transferimit, kontrata e shitjes, kontrata e dhurimit).
8. Pezullimi i audituesit ligjor mund të kryhet edhe në rastin kur ndaj tij është marrë masa disiplinore “pezullim i përkohshëm, për një kohë jo më shumë se pesë vjet” e përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 55 të ligjit për auditimin, e cila jepet në rastet kur:
 - a. Ka përsëritje të shkeljes, më shumë se dy herë, të pikave 4, 5, 7 e 8 të nenit 55 të ligjit për auditimin;
 - b. Audituesi ligjor, gjatë funksioneve të tij, kryen edhe funksionin e të punësuarit apo funksione të tjera, që janë në papajtueshmëri me profesionin e audituesit ligjor;
 - c. Marrja përsipër e misionit të auditimit është bërë pa respektuar procedurat e emërimit të tij, të parashikuara nga dispozitat e ligjit, si dhe nga rregullat e auditimit apo nga statuti;
 - ç. Vërtetohet se raporti i auditimit nuk bazohet në dokumentacionin që përmban dosja e auditimit. Nga investigimi pas vlerësimit me notën përfundimtare të kontrollit të cilësisë D ose F, si dhe me notën C, kur konsatohet se ka shkelje të kuadrit ligjor dhe akteve nënligjore në zbatim të tij të cilat sjellin dëmtimin e reputacionit apo plotësimin e kushteve për pezullim⁷
 - d. Nga rezultatet e kontrollit të cilësisë rezulton vlerësimi “dobët”.
 - dh. Ka mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet deklaratimit vjetor të kohës, sipas angazhimeve të kryera, dhe kohës në dispozicion të llogarit, duke mbajtur parasysh bashkëpunëtorët dhe të punësuarit e deklaruar, si dhe

⁷ Shtuar me Vendim Nr. 31, datë 28.05.2020 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

mosdeklarimin e bashkëpunëtorëve e të punësuarve.

Neni 11

Ri-regjistrimi në regjistrin publik të audituesve ligjorë

1. Anëtari i tërhequr përkohësisht nga ushtrimi i profesionit (anëtar jo aktiv) mund të kërkojë ri-regjistrimin e tij.
2. Riregjistrimi nga Komiteti i Regjistrimit bëhet nëse audituesi ligjor ka përmbushur të gjitha detyrimet e kualifikimit të vijueshëm profesional edhe gjatë kohës kur ai nuk e ka ushtruar profesionin.
3. Audituesi ligjor i adresohet Komitetit të Regjistrimit, përmes organizatës profesionale të audituesve ligjorë dhe dorëzon dokumentet e mëposhtme:
 - Kërkesë për ri-regjistrim drejtuar Komitetit të Regjistrimit, e nënshkruar prej tij;
 - Vërtetim nga organizata profesionale e audituesve ligjorë për kryerjen e kualifikimit të vijueshëm profesional për kohën që nuk ka ushtruar profesionin e audituesit ligjor. Në rastin kur kryhen pranë organizatës profesionale ato dorëzohen nga organizata drejtpërdrejtë te Komiteti i Regjistrimit pa pasur nevojë për lëshimin e një vërtetimi.
Në rastet kur kualifikimi i vijueshëm nuk është bërë pranë organizatës profesionale, një vërtetim nga institucioni në përputhje me dispozitat e ligjit për kryerjen e kualifikimit të vijueshëm profesional për kohën që nuk ka ushtruar profesionin e audituesit ligjor.
 - Curriculum vitae;
 - Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
 - Dëshmi penaliteti që tregon se aplikuesi nuk është i dënuar;
 - Deklaratë noteriale për dhënien fund të papajtueshmërive që kërkojnë për ushtrimin e profesionit;
 - Vërtetim nga organizata profesionale e audituesve ligjorë për shlyerjen e detyrimeve financiare lidhur me kuotat e anëtarësisë dhe detyrime të tjera;
 - Certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe kopje të Ekstraktit të QKB.
 - Në rastet kur në momentin e aplikimit nuk zotërohet dëshmia e penalitetit dhe vërtetimi i gjendjes gjyqësore, aplikuesi dorëzon një vetëdeklarim mbi gjendjen gjyqësore deri në dorëzimin e dokumenteve të përcaktuara në këtë nen.

Neni 12

Çregjistrimi nga regjistri publik i audituesve ligjorë

1. Çregjistrimi në regjistrin publik bëhet në kushtet e parashikuara në nenin 26 të ligjit nr.10091/2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në përmbushjen e

kushteve të parashikuara në ligj Komiteti i Regjistrimit merr masat për çregjistrimin.

KREU IV

MBIKËQYRJA E FUNKSIONIMIT TË KOMITETIT TË REGJISTRIMIT

Neni 13

Mbikëqyrja e funksionimit të Komitetit të Regjistrimit

1. Organizata profesionale e audituesve ligjorë dërgon pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike në mënyrë periodike, të paktën 2 herë në vit, një raport lidhur me veprimtarinë e Komitetit të Regjistrimit, si dhe ndryshimet në Regjistrin Publik së bashku me informacione të tjera të kërkuara nga BMP.
2. Në rast se nëpërmjet raportit evidentohen problematika të cilat bien ndesh me këtë rregullore apo me ligjin apo me çdo vendim të nxjerrë nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, ky i fundit mblidhet për të shqyrtuar problematikën në fjalë. Përfundimet e shqyrtimit iu vihen në dijeni organizatës profesionale të audituesve ligjorë, e cila duhet të marrë masa për zgjidhjen e kësaj problematike.
3. Sekretaria teknike e Komitetit të Regjistrimit duhet të njoftojë Bordin e Mbikëqyrjes Publike për rendin e ditës të mbledhjes si dhe datën dhe orën e zhvillimit të saj.
4. Bordi i Mbikëqyrjes Publike kur e vlerëson të nevojshme mund të caktojë një person i cili merr pjesë në mbledhjen e Komitetit të Regjistrimit.

Neni 13/1⁸

Mbikëqyrja nëpërmjet inspektimeve tematike

1. Bordi i Mbikëqyrjes Publike zhvillon inspektime tematike pranë organizatës profesionale të audituesve ligjorë (IEKA) me objekt zbatimin dhe verifikimin e dokumentacionit të dosjeve të regjistrimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, në pajtueshmëri me dispozitat e kësaj rregulloreje.
2. Inspektimi mund të zhvillohet:
 - a. nëpërmjet verifikimit në terren të dokumentacionit të dosjeve të regjistrimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, pranë organizatës profesionale të audituesve ligjorë (IEKA) nga Struktura Mbështetëse e Bordit të Mbikëqyrjes Publike.
 - b. nëpërmjet kërkesës për dhënie informacioni mbi dokumentacionin e dosjeve të regjistrimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive të

⁸ Shtuar me Vendim Nr. 31, datë 28.05.2020 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

auditimit.

3. Fazat e inspektimit do të jenë:
 - a. Njoftimi
 - b. Vizita në terren sipas afateve të përcaktuara në vendim
 - c. Lëshimi i raportit të inspektimit
4. Inspektimi i parashikuar në këtë rregullore do të jetë subjekt i kontrollit të brendshëm të cilësisë i cili kryhet nga Drejtori Ekzekutiv. Ky kontroll i brendshëm cilësie mund të delegohet prej tij tek komisioni ligjor apo personeli i SM, që nuk ka konflikt interesi.
5. Ruajtja e dokumentacionit:
 - a. Dokumentacioni origjinal ruhet pranë organizatës profesionale të audituesve ligjor. Kopje të dokumentacionit dhe evidencave e kërkuara përgjatë inspektimit nga Struktura Mbështetëse të cilat janë të rëndësishme për të mbështetur raportin e inspektimit ruhen pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike.
 - b. Dokumentacioni i dosjeve të regjistrimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit do të ruhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, duke përfshirë edhe ruajtjen e dosjeve për rastet që janë pezulluar apo çregjistruar.
6. Në rastin e inspektimeve, mbikëqyrjes, monitorimit të parashikuara në këtë rregullore Drejtori Ekzekutiv i BMP emëron të paktën një person, në varësi të aktiviteteve të parashikuara në këtë rregullore të cilët angazhohen për të realizuar procesin e inspektimit, mbikëqyrjes ose monitorimit.

Neni 14

Shqyrtimi i ankimeve

1. Bordi i Mbikëqyrjes Publike shqyrton dhe merr vendim për ankesat e bëra nga aplikuesit, në lidhje me regjistrimin e tyre.
2. Në rast se konstatohen papajtueshmëri materiale në zbatimin e kërkesave ligjore apo akteve nënligjore në zbatim të tij Bordi Mbikëqyrjes Publike mund të fillojë një proces investigimi për të gjithë personat e përfshirë në vendimmarrje të cilët me veprimet ose mosveprimet e tyre kanë penguar zbatimin e detyrimeve ligjore dhe akteve nënligjore si dhe kanë dëmtuar ndjeshëm reputacionin individual si zotërues të titullit AL ose Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjor ose Bordit të Mbikëqyrjes Publike. Në rast se konstatohen shkelje, Bordi Mbikëqyrjes Publike adreson korrigjimin e situatës në përputhje me dispozitat e ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar dhe ligjit nr. 9917 datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit” i ndryshuar dhe ligjit nr.157/2013 “Për masat e marra kundër financimit të terrorizimit”, i ndryshuar.⁹
3. Vendosija e masave sipas ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i

⁹ Shtuar me Vendim Nr. 31, datë 28.05.2020 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

ndryshuar, nuk ndalon paraqitjen e kallëzimit penal në organet e prokurorisë, nëse brenda afatit të përcaktuar në vendim nuk merren masa për korrigjimin e situatës.¹⁰

KREU V

PROCEDURAT E ORGANIZATËS PROFESIONALE TË AUDITUESVE LIGJORË PËR PASQYRIMIN E NDRYSHIMEVE NË REGJISTRIN PUBLIK

Neni 15

Përditësimi i Regjistrit Publik

1. Organizata profesionale është struktura përgjegjëse që siguron:
 - a) mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese;
 - b) identifikimin e audituesit ligjor dhe të shoqërisë audituese në regjistrin publik, me një numër individual;
 - c) publikimin në regjistër i të gjithë anëtareve jo aktiv (audituesit ligjor të tërhequr përkohësisht apo që nuk e ushtrojnë profesionin).
2. Regjistri publik në format elektronik publikohet në faqen zyrtare të internetit të organizatës profesionale në gjuhën shqipe sipas formatit të miratuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.
3. Regjistri publik, mund të mbahet edhe në formë dokumenti për nevoja të organizatës profesionale.
4. Audituesi ligjor apo shoqëria audituese, njofton organizatën profesionale të audituesve ligjorë për ndryshimet e informacioneve të detyrueshme për publikim dhe të regjistruar në regjistrin publik lidhur me ndryshimet. Në rast të ndryshimit të administratorëve apo kuotave të aksioneve, njoftimi shoqërohet me kopje të ekstraktit të QKB, kontratën e shitblerjes së aksioneve/të pjesëve, si dhe çdo dokument tjetër që gjykohet i nevojshëm.
5. Organizata profesionale, me marrjen e njoftimit dhe hartimin e relacionit për vlerësimin e plotësimit të kushteve të parashikuara në ligj, brenda një periudhe 10-ditore, kryen përditësimin e informacionit të regjistrit publik në faqen zyrtare të internetit.
6. Në rastet kur shkelen kushtet dhe/ose kur ndryshojnë rrethanat e parashikuara në këtë rregullore, të cilat konsiderohen të domosdoshme për regjistrimin e një audituesi ligjor apo shoqërie audituese, organizata profesionale vë në dijeni Bordin e Mbikëqyrjes Publike.
7. Organizata profesionale e audituesve ligjorë publikon, në një aneks të veçantë të regjistrit publik, të gjithë individët e parashikuar në nenin 26, pika 1, shkronja “e”, të Ligjit nr.10091/2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Këta individë mund ta ushtrojnë profesionin e audituesit ligjor vetëm nëse janë të punësuar ose të angazhuar në një shoqëri auditimi, të regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë, që ka jo më pak se dy ortakë angazhimi dhe nën përgjegjësinë e kësaj të fundit.

¹⁰ Shtuar me Vendim Nr. 31, datë 28.05.2020 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

Neni 16

Kostot e regjistrimit

Shpenzimet e regjistrimit në regjistrin publik mbulohen nga aplikuesit. Organizata profesionale e audituesve ligjorë përcakton tarifat sipas natyrës së shërbimit dhe ja propozon Bordit të Mbikëqyrjes Publike për t'i miratuar brenda 60 ditëve nga miratimi i kësaj rregulloreje.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 17

Dispozita të fundit dhe hyrja në fuqi

1. Ngarkohet organizata profesionale e audituesve ligjorë, Komiteti i Regjistrimit, Bordi Mbikëqyrjes Publike si dhe të gjithë subjektet e parashikuar në dispozitat më sipër për zbatimin e kërkesave të kësaj rregullore.
2. Në rast se ka konflikt midis dispozitave të kësaj rregullore dhe rregullores nr. 2, datë 22.02. 2018 miratuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, "Për funksionimin e Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale dhe mbikëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për auditues ligjor dhe kontabilist të miratuar," dispozitat e rregullores nr. 2 mbizotërojnë.
3. Të gjitha çështjet në këtë rregullore të cilat nuk janë parashikuar as në rregulloret e tjera do të rregullohen me vendime të veçanta të BMP-së, si dhe nga legjislacioni në fuqi.
4. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

Kryetar

Dritan FINO